

утврдени во склучените договори, се до денот на примената на правилата утврдени од страна на Советот на Агенцијата за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги, согласно член 36 од овој закон со којшто се врши измена на член 143 од Законот за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги („Службен весник на Република Македонија“ број 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 и 132/17).

#### Член 47

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

### L I G J

#### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

##### Neni 1

Në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 dhe 132/17), neni 4 paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

"(7) Puna e Agjencisë financohet me mjetet e siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga të ardhurat e kompensimeve të parapara me këtë ligj, si dhe me huat dhe ndihmën tjetër financiare dhe teknike."

##### Neni 2

Në nenin 12 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"(3) Anëtarët e Këshillit nëse veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, përgjigjen në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për dëmin e shkaktuar me vendimin e tillë. Nuk do të konsiderohet përgjegjës ai anëtar i Këshillit i cili ka sugjeruar se mënyra e veprimit është në kundërshtim me këtë ligj, me mënyrën që e ka veçuar mendimin e vet në procesverbalin e mbledhjes."

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"(4) Anëtarët e Këshillit janë të angazhuar në mënyrë profesionale në Agjencinë me orar të plotë të punës me të drejtë të:

- kompensimit mujor në lartësi deri në katër rroga mujore mesatare në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës, në pajtim me Rregulloren e Punës së Agjencisë,

- kompensimit për shpenzimet rrugore, akomodimin dhe mëditjet për udhëtimin zyrtar në pajtim me Ligjin për rrogë dhe kompensime tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë."

Pas paragrafit (7) shtohet paragraf i ri 8 si vijon:

"(8) Këshilli për kompetencat nga neni 18 alineja (15) të këtij ligji vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit në të cilin duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë."

Paragrafi (8) bëhet paragraf (9).

##### Neni 3

Neni 14 ndryshohet si vijon:

##### "Neni 14

#### Emërimi i anëtarëve të Këshillit

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i emëron anëtarët e Këshillit në bazë të konkursit publik të zbatuar paraprakisht dhe debatit të organizuar publik për kandidatët për anëtarë të Këshillit.

(2) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë shpall konkurs publik në të cilin mund të paraqiten kandidatët për anëtarë të Këshillit, më së voni gjashtë muaj para skadimit të mandatit të anëtarit të Këshillit.

(3) Kandidatët për anëtarë të Këshillit të cilët janë paraqitur në konkursin publik kanë për detyrë të dorëzojnë kandidaturë në të cilën hollësisht do ta theksojnë përvojën e vet të punës dhe arritjet në sferën për të cilën janë profesionalë, deklaratë se i përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji dhe letra për mbështetje nga:

- dy organizata civile të cilat janë aktive më gjatë se pesë vjet dhe të cilat kanë arritur rezultate në sferën e medieve dhe të drejtave të njeriut ose

- së paku një shoqatë gazetarësh ose

- shoqatë relevante, asociacion apo odë nga sfera e teknologjive dhe shërbimeve komunikuese-informatike ose

- dy institucione të arsimit të lartë të cilat kanë programe studimore nga sfera e komunikologjisë, gazetarisë, kulturës, ekonomisë apo të drejtës.

(4) Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve ka për detyrë të kontrollojë nëse kandidatët të cilët janë paraqitur në konkurs i përmbushin kushtet për paraqitjen në konkursin publik, si dhe kushtet për parandalim të konfliktit të interesave, të përcaktuara në nenin 16 të këtij Ligji.

(5) Komisioni ka për detyrë në afat prej një muaji pas përfundimit të konkursit publik të organizojë debat publik për kandidatët të cilët i përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 16 të këtij Ligji, në të cilin do t'i ftojë organizatorët të cilët u kanë dhënë mbështetje kandidatëve, organizatat profesionale të gazetarëve dhe organizatat tjera të medieve, organizatat joqeveritare nga sfera mediatike dhe subjektet tjera relevante.

(6) Pas përfundimit të debatit publik, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve e përpilon propozim-listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit. Për propozim-listën përfundimtare të kandidatëve për anëtarë të Këshillit, Komisioni vendos me shumicën e dy të tretave.

(7) Gjatë përcaktimit të propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë mban llogari për përfaqësimin përkatës dhe të drejtë gjinor dhe përfaqësimin etnik të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

(8) Gjatë përcaktimit të propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë nuk guxon të propozojë më shumë se dy kandidatë të mbështetur nga i njëjti mbështetës të përcaktuar në paragrafin (3) të këtij ligji.

(9) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i emëron anëtarët e Këshillit, me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve që u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

(10) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni një muaj para skadimit të mandatit të anëtarit të Këshillit, duhet të emërojë anëtar të ri të Këshillit.

(11) Kryetari i Këshillit ka për detyrë ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për skadimin e mandatit të anëtarit të Këshillit jo më vonë se gjashtë muaj para skadimit të tij.

(12) Kryetari apo anëtarët e Këshillit të cilët i ushtrorjnë këto funksione mund të shkarkohen nëse nuk i përmbushin më tej kushtet e nevojshme për ushtrimin e funksionit. Procedura për shkarkim është publike."

Neni 4

Neni 15 ndryshohet si vijon:

"Neni 15

Mandati i anëtarëve të Këshillit

(1) Anëtarët e Këshillit emërohen për periudhë prej pesë vitesh.

(2) Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë edhe për një mandat, në bazë të procedurës së njëjtë të përcaktuar në nenin 14 të këtij Ligji.

(3) Në rast kur anëtari i Këshillit do të japë dorëheqje apo mandati do t'i pushojë para skadimit të kohës për të cilën është emëruar, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do të emërojë anëtar të ri të Këshillit në bazë të procedurës së njëjtë të përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji.

(4) Këshilli mund të punojë nëse janë emëruar së paku pesë anëtarë të Këshillit. (5) Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nuk guxon të kërkojë apo të pranojë udhëzime nga cilido trup në lidhje me kryerjen e detyrave të cilat u janë ndarë sipas këtij ligji. Kjo nuk e parandalon mbikëqyrjen mbi Agjencinë, të caktuar me ligj."

Neni 5

Në nenin 16 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Anëtarë të Këshillit mund të jenë personat shtetas të Republikës së Maqedonisë me arsim të lartë, me përvojë të punës prej së paku tetë vjet në profesion dhe të cilët në publik janë shquar në sferën e komunikologjisë, gazetarisë, informatikës, kulturës, ekonomisë apo të drejtës."

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"(3) Anëtarë të Këshillit nuk mund të zgjidhen personat që kanë qenë anëtarë të organeve udhëheqëse të partive politike në 10 vitet e fundit, duke llogaritur nga dita e shpalljes së Konkursit."

Neni 6

Në nenin 18 lidhëza "dhe" në alinenë 19 zëvendësohet me presje.

Pas alinesë 19 shtohen dy aline të reja si vijojnë:

"- miraton vendime për marrjen e masave në pajtim me këtë ligj në rastet kur janë shkelur dispozitat e këtij ligji apo rregullat e miratuara në bazë të tij dhe kushtet dhe obligimet nga lejet,

- miraton vendime për marrjen e masave për kufizimin e përkohshëm të transmetimit dhe pranimit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nga shtetet tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe".

Alineja 20 bëhet alineja 22.

Neni 7

Në nenin 19 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Këshilli zgjedh drejtor të Agjencisë nëpërmjet konkursit publik. Kandidati doemos duhet të ketë të mbaruar arsim të lartë dhe përvojë pune prej së paku tetë vjet nga sfera e komunikologjisë, gazetarisë, informatikës, kulturës, ekonomisë apo të drejtës, si dhe përvojë në udhëheqjen me organizatë prej së paku katër vjet."

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijojnë:

"(2) Kandidati për drejtor të Agjencisë së SHMAA-së mos të ketë qenë anëtar në organet dhe trupat e partisë politike dhe mos të jetë person i zgjedhur apo i emëruar, funksionar i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, ministrinë apo organin udhëheqës të ndërmarrjes publike dhe shoqërisë aksionare, të themeluara nga shteti në periudhën prej 10 vitesh, duke llogaritur mbrapsht prej vitit në të cilin e parashtron kandidaturën.

(3) Kandidati i zgjedhur për drejtor të Agjencisë së SHMAA-së nuk guxon të jetë anëtar në organet dhe trupat e partisë politike në periudhën derisa e ushtron funksionin."

Paragrafi (8), i cili bëhet paragraf (10) ndryshohet si vijon:

"(10) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni vlejnjë edhe për zëvendësdirjtorin e Agjencisë."

Paragrafët (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) bëhen paragrafë (4), (5), (6), (7), (8), (9) dhe (10).

Neni 8

Në nenin 20 në paragrafin (1) alinetë 8 dhe 9 shlyhen.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"(3) Mandati i drejtorit është pesë vjet, me të drejtë edhe për një mandat."

Neni 9

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Neni 23

Masat në rast të shkeljes së rregullave

(1) Nëse konstatohet mosrespektimi apo shkelja e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënljigjore të miratuara në bazë të tij, si dhe kushteve dhe obligimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet tjera të Agjencisë, kundër botuesit të medias, dhënësit të shërbimeve audiovizuale me kërkesë apo operatorit të rrjeteve komunikuese elektronike publike që bën riemetimin e serviseve programore, Këshilli i Agjencisë mund t'i marrë masat në vijim:

- vërejtje publike,

- do të ngrejë procedurë të kundërvajtjes në rast kur dhe krahas shqiptimit të vërejtjes publike nuk e ndërpret shkeljen dhe vazhdon me kryerjen e shkeljes së njëjtë për të cilën i është tërhequr vërejtja, në afatin e përcaktuar nga Këshilli i Agjencisë, në pajtim me dispozitat e këtij ligji,

- heqje e lejes apo

- do të zbatojë procedurë për shlyerjen nga regjistri i dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuale apo nga regjistri i radiodifuzerëve, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Për masat e shqiptuara nga paragrafi 1 alinetë 1 dhe 4 Këshilli i Agjencisë miraton aktvendim përkatës. Për masën nga alineja 2 Këshilli i Agjencisë miraton propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje. Për masën nga alineja 3 Këshilli i Agjencisë miraton vendim. Kundër aktvendimeve dhe vendimeve të miratuara lejohet mbrojtja gjyqësore, në pajtim me nenin 24 të këtij ligji.

(3) Para shqiptimit të vërejtjes publike, Këshilli i Agjencisë do të kërkojë nga botuesi i medias të prononcohet në formë me shkrim për mosrespektimin apo shkeljen e bërë të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënljigjore të miratuara në bazë të tij, si dhe kushteve dhe obligimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet tjera të Agjencisë.

(4) Para shqiptimit të masave nga paragrafi (1) alinetë 3 dhe 4, Këshilli i Agjencisë ka për detyrë të sigurojë mbledhje publike në të cilën përfaqësuesi i medias do t'i arsyetojë dhe argumentojë procedurat dhe shkaqet për veprimin e medias.

(5) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni, nëse përcaktohet mosrespektimi i dispozitave nga neni 91 të këtij ligji, Këshilli i Agjencisë do të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes pa miratuar paraprakisht aktvendim për vërejte publike.

(6) Masat e shqiptuara të përcaktuara me këtë nen, me arsyetim të hollësishëm, Agjencia i dorëzon me shkrim të kryerësi i kundërvajtjes në afat prej tri ditësh, duke llogaritur nga dita e shqiptimit të tyre dhe të njëjtat i publikon në faqen e vet të internetit."

#### Neni 10

Në nenin 30 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Mbikëqyrja profesionale mbi radiodifuzerët bëhet nga personat e punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë, pas autorizimit paraprak nga Këshilli i Agjencisë, vetëm për shkak të përcaktimit të përmbushjes së kushteve teknike në pajtim me lejen për emetim televiziv apo emetim në radio."

#### Neni 11

Neni 48 ndryshon si vijon:

#### "Neni 48

##### Ndalime të veçanta

(1) Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nuk guxojnë të përmbajnë programe me të cilat rrezikohet siguria kombëtare, nxitet përmbysja e dhunshme e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thirret në agresion ushtarak apo konflikt të armatosur, inkurajohet ose përhapet diskriminim, mosdurim ose urrejtje në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, përkatësisë nacionale apo etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, orientimit gjinor, përkatësisë së grupit të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, arsimit, religjionit apo bindjes fetare, bindjes politike, bindjes tjetër, pengesës, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes pronësore, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit shoqëror, ose në çfarëdo baze tjetër.

(2) Ndalimet e veçanta nga paragrafi (1) të këtij neni duhet të jenë në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

#### Neni 12

Në nenin 80 në paragrafin (2) formula ndryshon si vijon:

$$"(N \times BPV / 200.000) \times Rt \times Kp) + A) \times 0.7"$$

Pas paragrafit (6) shtohen tre paragrafë të rinj, si vijojnë:

"(7) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat transmetojnë program në radio dhe të cilat në fillim të vitit kalendarik vullnetarisht do të paraqesin te Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale përqindjen e transmetimit të muzikës në gjuhën maqedonase dhe bashkësive etnike, për të njëjtën përqindje do të fitojnë uljen e lartësisë së kompensimit për licencën.

(8) Ulja minimale e kompensimit për licencë mbi këtë bazë mund të jetë 10% ndërsa maksimalja deri në 30%. Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat transmetojnë program në radio dhe të cilat transmetojnë muzikë prej

30% në gjuhën maqedonase dhe të bashkësive etnike, nuk mund të fitojnë ulje për kompensimin për licencë më tepër se 30%.

(9) Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, do të miratojë akt nënligjor me të cilin do të përcaktojë plan për kohën dhe zhanrin e transmetimit të muzikës në gjuhën maqedonase dhe të bashkësive etnike për shoqëritë tregtare të cilat transmetojnë program në radio."

#### Neni 13

Neni 92 ndryshon si vijon:

#### "Neni 92

Obligimet e radiodifuzerëve për transmetimin e programit në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive në Republikën e Maqedonisë

(1) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat transmetojnë servis programor televiziv obligohen në ditë të transmetojnë së paku 30% program burimor të krijuar si vepra audio ose audiovizuale, ndërsa servisi publik radiodifuziv së paku 40%.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) të këtij neni nuk vlen për serviset programore të formatit të specializuar.

(3) Shoqëritë tregtare radiodifuzive të cilat transmetojnë servis programor televiziv së paku gjysma e obligimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni t'i realizojnë gjatë periudhës nga ora 7,00 – 19,00.

(4) Servisi publik radiodifuziv është i obliguar për së paku një radio servis programor në gjuhën maqedonase dhe radio servis programor në gjuhët e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, në ditë të sigurojnë së paku 50% të transmetimit të muzikës instrumentale, vokale dhe/ose vokale instrumentale burimore të krijuar në Republikën e Maqedonisë, të jetë në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë, ndërsa në servisin programor të dytë në gjuhën maqedonase në ditë të sigurojë së paku 30% të transmetimit të muzikës instrumentale, vokale dhe/ose vokale instrumentale burimore të krijuar në Republikën e Maqedonisë, të jetë në gjuhën maqedonase.

(5) Rregullat për zbatimin e obligimeve nga ky nen më detajisht i përcakton Agjencia."

#### Neni 14

Neni 92-a, shlyhet.

#### Neni 15

Neni 92-b, shlyhet.

#### Neni 16

Neni 92-v, shlyhet.

#### Neni 17

Neni 92-g, shlyhet.

#### Neni 18

Neni 92-d, shlyhet.

#### Neni 19

Neni 92-gj, shlyhet.

#### Neni 20

Neni 92-e, shlyhet.

#### Neni 21

Neni 92-zh, shlyhet.

Neni 22  
Neni 92-z, shlyhet.

Neni 23  
Neni 92-x, shlyhet.

Neni 24  
Neni 92-i, shlyhet.

Neni 25  
Neni 102 ndryshohet si vijon :

"Neni 102  
Ndalimi i reklamimit

Organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, ndërmarjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, entet dhe institucionet publike si dhe personat juridikë me autorizime publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore nuk guxojnë të parashikojnë mjete për informimin dhe njoftimin e publikut me shërbimet ose aktivitetet e veta nëpërmjet radiodifuzerëve privatë."

Neni 26  
Neni 103, shlyhet.

Neni 27  
Neni 105 ndryshon si vijon:

"Neni 105  
Financimi i RTM-së

(1) Mjetet për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, për punën dhe zhvillimin e Radio Televizionit të Maqedonisë, Ndërmarrjes Publike Radiodifuzioni i Maqedonisë dhe Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në lartësi prej 0.8% deri në 1% të të ardhurave të përgjithshme të realizuara në vitin i cili i paraprin vitit fiskal për të cilin përcaktohet shuma.

(2) Mjetet nga paragrafi 1 shpërndahen në mënyrën si vijon:

- 74.5% për RTM-në për mbulimin e shpenzimeve për krijimin dhe transmetimin e programeve dhe për zhvillim teknik - teknologjik,

- 19,5% për NP Radiodifuzioni i Maqedonisë për mirëmbajtjen, përdorimin dhe zhvillimin e rrjetit publik radiodifuziv dhe

- 6% për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

(3) Burim shtesë i mjeteve për financim të RTM-së janë donacione, shitja e programeve dhe shërbimeve, si dhe mjetet e krijuara nga transmetimi i komunikimeve komerciale audio dhe audiovizive të transmetuara në kuadër të përmbytjes së programeve të ofruara në bazë të marrëveshjeve të posaçme të lidhura me ofruarit e veprave audio ose audiovizuale me të drejtën autoriale të mbrojtura, në përputhje me kushtet e marrëveshjes.

(4) Donacionet nga paragrafi (3) të këtij neni nuk guxon të ndikojnë ose ta prishin pavarësinë redaktuese të RTM-së.

(5) RTM-ja obligohet për furnizimin e veprave audio dhe audiovizuale, respektivisht për përmbytjen programore të lidhë marrëveshje të veçantë me siguruesin e veprave audio dhe audiovizuale respektivisht me përmbytje programore.

(6) Mënyrën dhe procedurën e realizimit të konkurseve, mënyrën dhe procedurën për furnizim të veprave audio dhe audiovizuale, respektivisht përmbytja programore dhe

lidhja e marrëveshjeve përcaktohen me akt të miratuar nga drejtori i cili duhet të sigurojë transparencë, ekonomi, efikasitet dhe efektivitet në menaxhimin e mjeteve financiare të RTM-së, në pajtim me programin vjetor për punën e RTM-së, për vitin e ardhshëm, me këtë ligj dhe aktet të cilat burojnë prej tij.

(7) Për të arritur dhe mbajtur shkallë më të lartë të zhvillimit programor dhe teknik-teknologjik të servisit publik radiodifuziv mund të akordohen mjete plotësuese edhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për këtë qëllim.

(8) Nëse RTM-ja nuk i shpenzon të gjitha mjetet e siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë gjatë vitit, mjetet tepriç të përcaktuara në pajtim me raportin vjetor financiar kthehen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(9) Mjetet nga paragrafi 1 të këtij neni sigurohen nëpërmjet Buxhetit të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

(10) Mënyra e financimit të serviseve programore dhe menaxhimi financiar do të rregullohen me Rregullore dhe aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Programor."

Neni 28

Neni 106 ndryshon si vijon:

"Neni 106

Raporti vjetor dhe programi vjetor për punën e RTM-së

(1) RTM-ja obligohet çdo pesë vjet të paraqesë strategji për zhvillim për pesë vitet e ardhshme e cila përmban edhe plane vjetore për implementim, që do të rishikohen çdo vit në bazë të analizës për zbatimin e strategjisë.

(2) RTM-ja miraton Program vjetor për punën dhe të njëjtën është e obliguar ta paraqesë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 30 tetor gjatë vitit rrjedhës, ndërsa e cila është në lidhje me vitin e ardhshëm dhe në veçanti duhet të përmbajë:

- program për punën për vitin e ardhshëm me aktivitetet të planifikuara në veçanti për plotësimin e obligimeve programore të RTM-së në pajtim me këtë ligj dhe

- plan financiar për vitin e ardhshëm i cili përmban të ardhurat e planifikuara dhe shpenzimet e RTM-së për vitin e ardhshëm të grupuara sipas strukturës dhe strukturës organizative të RTM-së, si dhe investimet e parashikuara kapitale të RTM-së për vitin e ardhshëm.

(3) Në shtojcë të programit vjetor për punën e RTM-së për vitin e ardhshëm parashitohet edhe programi i miratuar vjetor për punën e RTM-së për vitin rrjedhës.

(4) Planin financiar nga paragrafi (2) alineja 2 të këtij neni e aprovon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës.

(5) RTM-ja është e obliguar të miratojë Raport vjetor për punën për vitin e kaluar, RTM është e obliguar ta paraqesë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 31 mars gjatë vitit rrjedhës dhe i njëjti në veçanti duhet të përmbajë:

- raport për realizimin e programit për punën e vitit të kaluar,

- raport financiar për realizimin e planit financiar të vitit të kaluar dhe llogarinë vjetore, me të dhëna për realizimin e të hyrave, shpenzimeve, detyrimeve dhe obligimeve nga viti i kaluar të grupuar sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të RTM-së dhe

- raport të revizionit nga revizor i pavarur i autorizuar dhe raport të revizionit nga Enti Shtetëror për Revizion, nëse është kryer revizion nga ai, si dhe qëndrimin e RTM-së në lidhje me rezultatet e revizionit të kryer.

(6) Në shtojcë të raportit vjetor për punën e RTM-së për vitin e kaluar parashtrohet edhe programi i miratuar vjetor për punën e RTM-së për vitin e kaluar.

(7) Raporti vjetor për punën e vitit të kaluar dhe programi vjetor për punën për vitin e ardhshëm publikohen në ueb faqen e RTM-së."

Neni 29

Neni 107 ndryshohet si vijon:

"Neni 107

Programet dhe serviset programore me interes publik që i siguron RTM-ja

(1) RTM-ja në Republikën e Maqedonisë siguron së paku një servis programor televiziv në gjuhën maqedonase, një servis programor televiziv në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që është e ndryshme nga gjuha maqedonase, që do të emetojnë program 24 orë çdo ditë në javë, si dhe një servis programor televiziv i cili do të emetojë program në gjuhët e bashkësive tjera joshumicë në Republikën e Maqedonisë.

(2) RTM-ja në Republikën e Maqedonisë siguron së paku dy servise programore të radios në gjuhën maqedonase, një servis programor të radios në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që është e ndryshme nga gjuha maqedonase që emetojnë program 24 orë çdo ditë në javë dhe një servis programor të radios në gjuhën që e flasin bashkësitë tjera joshumicë i cili do të emetohet 24 orë.

(3) RTM-ja siguron programe të veçanta të radios të dedikuara për vendet fqinje dhe Evropën në gjuhët e huaja.

(4) RTM-ja siguron programe të veçanta të radios për informimin e emigrantëve dhe qytetarëve të Republikës së Maqedonisë të cilët jetojnë në vendet fqinje, në Evropë dhe në kontinentet tjera në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që është e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të bashkësive tjera joshumicë.

(5) RTM-ja siguron së paku një radio dhe një servis programor televiziv përmes satelitit dhe/apo internetit të dedikuar për emigrantët dhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët jetojnë në Evropë dhe në kontinentet tjera në gjuhën maqedonase, në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që është e ndryshme nga gjuha maqedonase që emetojnë program 24 orë çdo ditë në javë dhe në gjuhën që e flasin bashkësitë tjera joshumicë që do të emetohet 24 orë.

(6) RTM-ja e siguron servisin programor të Kanalit të Kuvendit të përcaktuar në Ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(7) Përgjegjësinë redaktuese për Kanalin e Kuvendit nga paragrafi (6) të këtij neni e ka RTM-ja, kurse skema programore e Kanalit të Kuvendit harmonizohet në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(8) RTM-ja siguron programe të veçanta të radios dhe të televizionit të serviseve programore nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni në të cilat janë ruajtur karakteristikat rajonale dhe lokale të Republikës së Maqedonisë."

Neni 30

Në nenin 109 paragrafi (1) fjalët: "mjetet për financim të veprimtarisë radiodifuzive në pajtim me këtë ligj." zëvendësohen me fjalët: "mjetet financiare nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë".

Në nenin 109 paragrafi (3) fjalët: "mjetet për financim të veprimtarisë radiodifuzive " zëvendësohen me fjalët: "mjetet financiare nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë".

Neni 31

Neni 117 ndryshohet si vijon:

"Neni 117

Mbështetësit e autorizuar të anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së

(1) Anëtarët e Këshillit Programor të RTM-së i emëron dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në bazë të konkursit publik të zbatuar paraprakisht dhe debatit të organizuar publik për kandidatët për anëtarë të Këshillit Programor.

(2) Kandidatët për anëtarë të Këshillit Programor të RTM-së duhet të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë me arsim të lartë, të kenë përvojë të punës prej së paku tetë vjet në profesionin, të cilët në opinion janë shquar në sferën e komunikologjisë, gazetarisë, informatikës, kulturës, ekonomisë apo të drejtës, me rëndësi për Këshillin Programor.

(3) Kandidatët për anëtarë të Këshillit Programor të RTM-së të cilët marrin pjesë në konkursin publik kanë për detyrë të dorëzojnë kandidaturë në të cilën hollësisht e theksojnë përvojën e tyre të punës, deklaratë për atë se i përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji dhe letra për mbështetje nga:

- së paku dy organizata civile të cilat janë aktive më gjatë se pesë vjet në sferën e përparimit të të drejtave të njeriut, medie dhe demokracisë dhe të cilët kanë arritur rezultate relevante në sferën në të cilën veprojnë ose

- së paku një shoqatë gazetarësh ose
- së paku dy shoqata nga sfera e kulturës (shoqata të artistëve të artit figurativë, shkrimtarë, punëtorë filmikë, dhe të ngajshme) ose

- shoqatë relevante, asociacion apo odë nga sfera e teknologjive dhe shërbimeve komunikuese informatike ose

- së paku dy institucione të arsimit të lartë të cilat kanë programe studimore nga sfera e komunikologjisë, gazetarisë, artit, ekonomisë apo të drejtës.

(4) Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve ka për detyrë të kontrollojë nëse kandidatët të cilët janë paraqitur në konkurs i përmbushin kushtet dhe rregullat për konflikt interesi të përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji dhe të organizojë debat publik për kandidatët e propozuar në të cilën do t'i ftojë organizatorët të cilët u kanë dhënë mbështetje kandidatëve, organizatat tjera mediatike dhe profesionale të gazetarëve, organizatat joqeveritare dhe subjektet tjera relevante.

(5) Pas përfundimit të debatit publik, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve e përpilon propozim-listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Programor të RTM-së. Për propozim-listën përfundimtare të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Programor të RTM-së, Komisioni vendos me shumicën e dy të tretave.

(6) Gjatë përcaktimit të propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë nuk guxon të propozojë më tepër se dy kandidatë të mbështetur nga mbështetësi i njëjti i përcaktuar me nenin (3) të këtij neni."

Neni 32

Neni 118 ndryshohet si vijon:

"Neni 118

Emërimi i anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së

(1) Gjatë përcaktimit të propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Programor, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së

Македонisë mban llogari për përfaqësimin përkatës dhe të drejtë gjinor dhe përfaqësimin etnik të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

(2) Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së është pesë vjet me të drejtë edhe të një mandati.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i emëron anëtarët e Këshillit Programor të RTM-së me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

(4) Në rast kur anëtari i Këshillit Programor të RTM-së do të japë dorëheqje apo mandati do t'i pushojë para skadimit të kohës për të cilën është emëruar, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do të emërojë anëtar të ri në bazë të procedurës së njëjtë të përcaktuar në nenin 117 të këtij Ligji.

(5) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë shpall thirrje publike për dorëzimin e aplikacioneve për anëtarë të Këshillit Programor, më së voni gjashtë muaj para skadimit të mandatit të anëtarit të Këshillit Programor.

(6) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni 15 ditë para skadimit të mandatit të Këshillit Programor të RTM-së do t'i emërojë anëtarët e rinj të Këshillit Programor të RTM-së.

(7) Këshilli Programor i RTM-së mund të punojë nëse janë emëruar së paku nëntë anëtarë."

Neni 33

Në nenin 130, paragrafët (3) dhe (4) ndryshohen si vijojnë:

"(3) Drejtor dhe zëvendësdrejtor i RTM-së mund të zgjidhet personi i cili do të ofrojë program më kualitativ të punës së MRT-së.

"(4) Drejtori dhe zëvendësdrejtori i RTM-së, krahas kushteve nga paragrafi (3) i këtij neni duhet të kenë edhe arsim të lartë, përvojë pune prej së paku tetë vjet në sferën e komunikologjisë, gazetarisë, informatikës, kulturës, ekonomisë apo të drejtës, si dhe përvojë me udhëheqjen e organizatës prej së paku katër vjet."

Neni 34

Kapitulli VII. "Mjetet për financim të veprimtarisë radiodifuzive" dhe neni 135 dhe neni 140 shlyhen.

Neni 35

Neni 143 ndryshohet si vijon:

"Neni 143

Obligimet e operatorit i cili riemeton servise programore

(1) Operatori mund t'i riemetojë serviset programore të radiodifuzerëve vendorë vetëm në zonën e servisit për të cilën radiodifuzerët e kanë marrë lejen për sigurimin e emetimit televiziv dhe të radios dhe në bazë të drejtave të rregulluara të autorit dhe të drejtave të ngjashme, në pajtim me Ligjin për të drejta të autorit dhe të drejta të ngjashme.

(2) Operatori mund të riemetojë servise programore të radiodifuzerëve nga shtetet tjera në pajtim me nenin 44 të këtij ligji dhe në bazë të drejtave të rregulluara të autorit dhe të drejtave të ngjashme, në pajtim me Ligjin për të drejta të autorit dhe të drejta të ngjashme.

(3) Me parashtrimin e fletëparaqitjes në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale personi përgjegjës i operatorit dhe personi përgjegjës i

radiodifuzerit dorëzon edhe deklaratë me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale me të cilën vërteton se për riemtimin e serviseve programore i ka rregulluar të drejtat televizive për radiodifuzerin e huaj i cili planifikon ta riemetojë në tërë servisin e vet programor për territorin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Në rast të riemimit të cilësdo pjesë të servisit programor të radiodifuzerit nga shteti tjetër, për të cilin servis programor ai radiodifuzer nuk ka rregulluar të drejta për territorin e Republikës së Maqedonisë, tërë përgjegjësia morale, materiale dhe penale bie mbi operatorin i cili riemeton atë servis programor dhe mbi radiodifuzerin, ndërsa procedurën për përcaktimin e përgjegjësise për shkeljen ose kundërvajtjen e kryer, si dhe mënyrën e regjistrimit të përfaqësuesit ligjor të radiodifuzerit nga shtet tjetër e përcakton Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale me akt nënligjor.

(5) Operatori i cili riemeton servise programore duhet të sigurojë pako programore që detyrimisht dhe falas t'i përmbajë serviset programore të servisit radiodifuziv publik.

(6) Operatori i cili riemeton servise programore ka për detyrë në marrëveshjet e parapagesës që i lidh me parapagesit e vet ta theksojë pakon programore, përkatësisht listën e serviseve programore që i riemeton në moment, për të cilat është lëshuar vërtetimi për regjistrim nga ana e Agjencisë.

(7) Operatori i cili riemeton servise programore ka për detyrë listën e serviseve programore që i riemeton, dhe për të cilat është lëshuar vërtetimi për regjistrim nga ana e Agjencisë, vazhdimisht ta azhurnojë në faqen e vet të internetit.

(8) Operatori i cili riemeton servise programore ka për detyrë të mbajë kontabilitet të posaçëm për aktivitetet lidhur me riemtimin e serviseve programore."

Neni 36

Neni 145 shlyhet.

Neni 37

Neni 146 shlyhet.

Neni 38

Në nenin 147 fjalia hyrëse e paragrafit (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Gjohë në shumë prej 1.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:"

Në paragrafin (1) pas pikës 9 shtohet pikë e re 10 si vijon:

"10) emeton dhe krijon programe me të cilat rrezikohet siguria kombëtare, nxitet përmbysja e dhunshme e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thirret në agresion ushtarak apo konflikt të armatosur, inkurajohet ose përhapet diskriminim, jotolerancë ose urrejtje në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës, përkatësisë nacionale ose etnike, polit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në grup të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, përkatësisë sociale, arsimit, religjionit apo bindjes fetare, bindjes politike, bindjes tjetër, pengesës, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit shoqëror, ose cila do bazë tjetër."

Pikat 10), 11), 12), 13), 14), 15), 16), 17) dhe 18) bëhen pikë 11), 12), 13), 14), 15), 16), 17), 18) dhe 19)

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:  
"(4) Përgjegjësia kundërvajtëse për kundërvajtje të kryer pas paragrafit (1) pika 10) të këtij neni nuk e përjashton edhe përgjegjësinë penale të përcaktuar me Kodin penal të Republikës së Maqedonisë."

#### Neni 39

Në nenin 148 paragrafi (1) pika 14) ndryshohet si vijon:

"14) nuk i respekton detyrimet nga neni 92 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;"

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3), si vijon:

"(3) Përgjegjësia e kundërvajtjes për kundërvajtje të kryer pas paragrafit (1) pika 27) të këtij neni nuk e përjashton edhe përgjegjësinë penale të përcaktuar me Kodin penal të Republikës së Maqedonisë."

#### Neni 40

Në nenin 149 paragrafi (1) pikat 8) dh 12) shlyhen.

Në nenin 149 paragrafi (1) pikat 9), 10), 11), 13), 14), 15) dhe 16) bëhen pika 8), 9), 10), 11), 12), 13), 14).

#### Neni 41

Në nenin 150 paragrafi (1) numrat 145 dhe 146 shlyhen.

Në paragrafin (2) numrat 145 dhe 146 shlyhen.

Në paragrafin (3) numrat 145 dhe 146 shlyhen.

#### Neni 42

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e shpall konkursin publik për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit të ASHMAA-së dhe Këshillit Programor të RTM-së në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe së paku dy medie të shtypura, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Kandidatët për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit të ASHMAA-së dhe anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së paraqiten në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të konkursit publik.

(3) Komisioni për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve e zbaton procedurën e plotë për zgjedhje në afat jo më të gjatë se 14 ditë nga përfundimi i afatit për paraqitje të kandidatëve.

(4) Kuvendi i zgjedh anëtarët të Këshillit të SHMAV dhe anëtarët të Këshillit Programor të RTM-së në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të listës nga ana e Komisionit për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve.

(5) Me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit dhe drejtorit të Agjencisë, si dhe anëtarëve të Këshillit programor dhe drejtorit dhe zëvendës drejtorit të RTM-së në pajtim me këtë ligj, pushon mandati i anëtarëve ekzistues të Këshillit dhe drejtorit të Agjencisë, si dhe anëtarëve të Këshillit programor të RTM-së dhe drejtorit dhe zëvendës drejtorit të RTM-së, me fuqi të këtij ligji.

#### Neni 43

(1) Anëtarët ekzistues të Këshillit dhe drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, si dhe anëtarët e Këshillit programor dhe drejtori dhe zëvendës drejtori i RTM-së e ushtrojnë funksionin deri në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit dhe drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, si dhe anëtarët e Këshillit programor dhe drejtori dhe zëvendës drejtori i RTM-së.

(2) Anëtarët ekzistues të Këshillit dhe drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, si dhe anëtarët të Këshillit programor dhe drejtori dhe zëvendës drejtori i RTM-së kanë të drejtë të

përjashtojnë kandidaturë për anëtarë të Këshillit dhe drejtor të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, si dhe anëtarët të Këshillit programor dhe drejtori dhe zëvendës drejtori i RTM-së, në pajtim me dispozitat të këtij ligji.

(3) Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Këshilli programor i RTM-së, të emëruar në pajtim me dispozitat të këtij ligji do t'i miratojnë aktet nënligjore në afat prej 60 ditësh nga dita e zgjedhjes së tyre.

(4) Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Këshilli programor i RTM-së nga paragrafi (3) të këtij neni do të miratojnë vendi për shpallje të konkursi publik për zgjedhje të drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, drejtorit dhe zëvendës drejtorit të RTM-së në afat prej 15 ditë nga dita e miratimit të rregulloreve për punë. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, drejtorit dhe zëvendës drejtorit të RTM-së do të bëhet në pajtim me dispozitat të këtij ligji dhe me rregulloret për punë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Këshillit programor të RTM-së.

#### Neni 44

Planin financiar për vitin 2018, RTM-ja është e obliguar ta dorëzojë te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni në afat prej 30 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Raportet financiare për vitin 2017 të RTM-së dhe të ASHMAA-së në mënyrë të obligueshme duhet të përmbajnë shpjegim të hollësishtëm dhe pasqyrë të hollësishtëme për periudhën nga tetori 2017 deri më 31.12.2017.

#### Neni 45

Përqindjet të përcaktuara me nenin 28 të cilat kanë të bëjnë me ndryshime të nenit 105, ndërsa me të cilat në paragrafin (1) caktohet lartësia e shumës të ndarë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, për çdo vit ndaras do të jenë:

- në vitin 2019 ndarja nga Buxheti do të jetë 0,8%,
- në vitin 2020 ndarja nga Buxheti do të jetë 0,9%,
- duke filluar nga viti 2021 do të jetë 1%.

Përqindjet nga paragrafi (1) të këtij neni do të realizohen nëse me ato nuk prishet shpërndarja e drejtë e mjeteve buxhetore dhe nuk ndikojnë në mjetet e planifikuara për të gjitha zërat buxhetorë të shpenzimeve.

#### Neni 46

Operatorët të cilët rriemtojnë servise programore të radiodifuzerëve të vendit në bazë të nenit 143 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 dhe 132/17) vazhdojnë t'i rriemtojnë serviset programor të radiodifuzerëve të vendit në mënyrë dhe me kushte të përcaktuara në marrëveshjet të lidhura, deri në ditën e zbatimit të rregullave të përcaktuar nga ana e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 36 të këtij ligji me të cilin bëhet ndryshimi i nenit 143 të Ligjit për shërbime meditime audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 dhe 132/17).

Neni 47

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

4643.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

**У К А З****ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ДАНОКОТ НА ДОБИВКА**

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за данокот на добивка,

што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 28 декември 2018 година.

Бр. 08-7557/1 Претседател  
28 декември 2018 година на Република Македонија,  
Скопје д-р **Горге Иванов**, с.р.

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
м-р **Талат Џафери**, с.р.

**ЗАКОН  
ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА  
ЗАКОНОТ ЗА ДАНОКОТ НА ДОБИВКА**

Член 1

Во Законот за данокот на добивка („Службен весник на Република Македонија” број 112/14, 129/15, 23/16 и 190/16) по членот 4 се додава нов член 4-а, кој гласи:

„Член 4-а

(1) Здруженијата на граѓани, фондациите, сојузите, како и секој организационен облик на странска организација, како и друга форма на здружување (во натамошниот текст: организации), регистрирани согласно со Законот за здруженија и фондации, не се обврзници за данок на добивка.

(2) Како неодамнешни приходи за организациите од ставот (1) на овој член се сметаат: приходи од членарини, доброволни прилози, донации, грантови, подароци (во пари, добра, имотни права), завештанија, легати, приходи од дивиденди од трговските друштва основани со средства на здружението, и приходи од Буџетот на Републиката, буџетите на единиците на локалната самоуправа и Буџетот на град Скопје врз основа на претходно изготвени програми (проекти) одобрени од Владата на Република Македонија, односно надлежните министерства, советите на единиците на локалната самоуправа и Советот на град Скопје.

(3) Организациите од ставот (1) на овој член кои остваруваат приходи од вршење стопанска дејност во рамките на нивното непрофитно делување, заради избегнување нелегална конкуренција со субјектите на кои добивката остварена од вршење стопанска дејност им се оданочува, стануваат обврзници за пресметување и плаќање данок на вкупен приход, доколку вкупниот годишен приход од стопанската дејност е поголем од 1.000.000 денари.

(4) Данокот на вкупен приход за обврзниците од ставот (3) на овој член се пресметува и плаќа во висина од 1% од износот на остварените вкупни приходи од стопанска дејност во календарската година, на износот кој надминува 1.000.000 денари.“

Член 2

Во членот 8 по зборот „расходи“ се додаваат зборовите: „и помалку искажаните приходи“.

Член 3

Во членот 9 став (1) точка 2) во алинејата 8 по зборот: „износ“ се додаваат зборовите: „но најмногу до 60.000 денари на годишно ниво“.

По точката 3-а) се додава нова точка 3-б), која гласи:

„3-б) надоместокот на трошоци за исхрана на вработените кои работат ноќно време, над износите утврдени со Законот за работните односи;“.

Во точката 5) зборот „четири“ се заменува со зборот „две“.

По точката 5) се додава нова точка 5-а) која гласи:

„5-а) трошоци по основ на уплатени премии за осигурување на живот над износот од две просечни месечни бруто плати, исплатени во претходната година во Република Македонија, на годишно ниво по вработен;“.

Во точката 7) зборовите: „и кусоци кои не се предизвикани од вонредни настани (кражба, пожар или други природни непогоди), кои не се на трошок на платата на одговорното лице“ се бришат.

По точката 7) се додава нова точка 7-а), која гласи:

„7-а) кусоци кои не се предизвикани од вонредни настани (кражба, пожар или други природни непогоди), кои не се на трошок на платата на одговорното лице;“.

По точката 10) се додава нова точка 10-а), која гласи:

„10-а) трошоците за донации во спортот согласно со членот 30-а од овој закон;“.

Во точката 16) сврзникот „и“ се заменува со точка и запирка.

Во точката 17) зборовите: „радиодифузна такса.“ се бришат.

По точката 17) се додава нова точка 18), која гласи:

„18) трошоците за нето износот на примањата по основ на деловна успешност над износот на кој се пресметани придонеси согласно со закон.“.

Член 4

По членот 9 се додава нов член 9-а, кој гласи:

„Член 9-а

(1) Непризнаени расходи за даночни цели се и трошоците за амортизација на ревалоризираната вредност на материјалните и нематеријалните средства.

(2) Трошоците за амортизација на материјалните и нематеријалните средства се признаваат како расход во даночниот биланс до износот пресметан на набавната вредност на средствата со примена на амортизационите стапки утврдени со Номенклатурата на средствата за амортизација.

(3) Одбраниот метод на амортизација се применува до конечна амортизација на поединечното средство или група средства.